



# Vështrim i përgjithshëm mbi **qendrat mësimore në Kosovë** dhe zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 19/2018

Mars 2023





Vështrim i përgjithshëm  
mbi **qendrat mësimore në  
Kosovë** dhe zbatimin e  
Udhëzimit administrativ nr.  
19/2018

Mars 2023



# Përmbajtja

<b>Përmbledhje ekzekutive.....</b>	<b>5</b>
<b>I. Hyrje.....</b>	<b>7</b>
1.1 <i>Arsimimi i nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës dhe roli i qendrave mësimore .....</i>	7
1.2 <i>Rruga drejt institucionalizimit.....</i>	10
<i>Metodologjia.....</i>	11
<b>II. Realiteti i ri ligjor për qendrat mësimore: Udhëzimi administrativ nr. 19/2018.....</b>	<b>12</b>
2.1 <i>Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/2018 .....</i>	14
<b>III. Funkcionimi dhe financimi i qendrave mësimore .....</b>	<b>15</b>
<i>Financimi .....</i>	19
<b>IV. Sfidat aktuale.....</b>	<b>22</b>
<b>V. Rruga Përpara .....</b>	<b>23</b>
<b>VI. Konstatime .....</b>	<b>25</b>
<b>VII. Rekomandime .....</b>	<b>25</b>



## Lista e Shkurtesave

<b>UA</b>	Udhëzim administrativ
<b>BSFK</b>	Balkan Sunflowers Kosova
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>PSAK</b>	Plani strategjik për arsimin në Kosovë
<b>GiZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, Agjencia Gjermane për Zhvillim
<b>PLV</b>	Plan lokal i veprimit
<b>QM</b>	Qendër mësimore
<b>KKK</b>	Komitet Komunal i Veprimit
<b>DKA</b>	Drejtori Komunale e Arsimit
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MM</b>	Memorandum mirëkuptimi
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>EPRBM</b>	Ekip për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit
<b>QR</b>	Qendër rajonale e OSBE-së
<b>TdH</b>	Terre des Hommes
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
<b>UP</b>	Universiteti i Prishtinës
<b>VoRAE</b>	Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve



## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport shqyrton gjendjen aktuale të zbatimit të Udhëzimit administrativ nr. 19/2018 (në tekstin e mëtutjeshëm UA nr. 19/2018) për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore dhe paraqet një panoramë të qendrave mësimore në Kosovë bazuar në hulumtimet e realizuara nga viti 2020 deri në vitin 2022 nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në pajtim me mandatin e tij për monitorimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut.


Qendrat mësimore (QM) kanë një histori të gjatë në Kosovë. QM-të i kanë mbështetur ndër vite fëmijët të cilët janë në pozitë të pafavorshme dhe vuajnë nga pasojat e marginalizimit socioekonomik, duke i përgatitur për regjistrim, u ofruar ndihmë shtesë në detyrat shkollore dhe ofruar aktivitete argëtuese dhe të tjera edukative. Po ashtu, ato kanë kontribuar edhe në dekurajimin e braktisjes së shkollës. Përkundër njohjes së rolit të rëndësishëm që luajnë QM-të me kontributin e tyre në arsimimin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, qëndrueshmëria e tyre ka qenë e rrezikuar për shkak të varësisë së madhe nga donatorët ndërkombëtarë për mbulimin e kostove të tyre kryesore operative. Si rrjedhim, ka pasur interes të madh që QM-të gradualisht të kalojnë nën patronatin e institucioneve të Kosovës.

Me qëllim krijimin e bazës ligjore dhe rregullimin e punës së QM-ve, Ministria e atëhershme e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) miratoi UA nr. 19/2018 në dhjetor të vitit 2018. Sipas kriteve të parapara me UA nr. 19/2018 për vendosjen e kornizave zyrtare për funksionimin e QM-ve, ato duhet të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit në mënyrë që të mund ta vazhdojnë ose fillojnë veprimtarinë. Pas miratimit të hapësirave fizike, personelit dhe planprogramit mësimor, si dhe të planit të punës dhe planit financiar, QM-të pajisen me leje pune pesëvjeçare, me mundësi të ripërtëritjes.<sup>1</sup> Në anën tjetër, UA nr. 19/2018 i ngarkon institucionet e nivelit qeveritar dhe komunal me më shumë përgjegjësi për sigurimin e funksionimit dhe financimit efikas e të qëndrueshëm të QM-ve. Në mesin e palëve vendore të interesit dhe MASHTI-t, hartimi dhe zbatimi i UA nr. 19/2018 është shndërruar në sinonim të institucionalizimit.

Vonesat, përfshirë në kuptim të financimit nga komunat dhe ministritë, si dhe mungesa e udhëzimeve procedurale, kanë ndikuar dukshëm në QM-të ekzistuese dhe shumë sosh janë mbyllur pas përfundimit të projekteve të donatorëve dhe mungesës së financimit. Në dhjetor të vitit 2022 kanë qenë gjithsej 47 QM funksionale në 17 komuna. Në periudhën prej vitit 2018 deri në prill 2022 janë mbyllur 53 QM, gjersa disa komuna kanë mbetur pa QM funksionale.

---

<sup>1</sup> Udhëzimi administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, gjendet tek: <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore/>



Disa donatorë ndërkombëtarë ngurrojnë tani më shumë që t'i mbulojnë kostot bazë në mungesë të financimit të nevojshëm nga palët përgjegjëse sipas legjislacionit, ndërkaq ato QM që ia kanë dalë të sigurojnë fonde nga donatorët mund të thuhet se kanë perspektivë financiare vetëm në afat të shkurtër ose të mesëm.

Pas dy vitesh mosrealizimi të premtimeve për financim dhe mospërkrahje të një linje të dedikuar për përmbushjen e detyrimeve financiare karshi QM-ve, MASHTI (Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit) ndau disa fonde (97,000 € për vetëm tri OJQ që menaxhojnë me QM në tetor 2021, dhe 200,000 € në korrik 2022). Ndonëse e mirëseardhur, as kjo shumë e as përfaqësuesit nuk janë të mjaftueshme në raport me numrin e QM-ve të regjistruara ose të paregjistruara. Paralelisht me këtë, disa komuna po përballen me sfida në lidhje me përgjegjësitë e tyre sipas UA nr. 19/2018, meqë nuk kanë as mjete, as bazë ligjore për të mbështetur aktivitete të tilla. Zbatimi i ngadalshëm i UA nr. 19/2018 ka gërryer besimin në nivel institucional meqë OJQ-të dhe përfaqësuesit e komunitetit vazhdojnë të kenë shqetësime për sa i përket qëndrueshmërisë afatgjatë të QM-ve, problem ky që institucionalizimi i QM-ve kishte si qëllim të ndihmonte ta adresojë, dhe përsëri detyrohen që t'u drejtohen një numri më të vogël donatorësh ndërkombëtarë në kërkim të mbështetjes që u nevojitet për të vazhduar me shërbimet e tyre ose, në të kundërtën, t'i ndërpresin tërësisht aktivitetet.

# I. Hyrje

## 1.1 Arsimimi i nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës dhe roli i qendrave mësimore

Ofrimi i arsimit për pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në nivel vendi shpesh pengohet nga shkalla e pakënaqshme e vijimit të shkollimit të detyrueshëm dhe shkalla tejet e ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë.<sup>2</sup> Sipas të dhënave të mbledhura nga MASHT për vitin shkollor 2018/19<sup>3</sup>, romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës përbëjnë 2.5 për qind (5,808 nxënës nga gjithsej 229,333) të numrit të gjithmbarshëm të nxënësve që vijnë në arsimin parafillor dhe fillor (të mesëm të ulët).<sup>4</sup> Të dhënat e MASHTI-t shpalosin se, në po të njëjtin vit shkollor, 107 fëmijë romë të Kosovës, 185 fëmijë ashkali të Kosovës dhe 60 fëmijë egjiptianë të Kosovës kanë qenë të regjistruar në nivel parafillor në shkollat publike të Kosovës.<sup>5</sup> Shkalla e ulët e vijimit të arsimit parafillor kompensohet disi nga QM-të në nivel vendi të cilat ofrojnë shërbime të arsimit parafillor, por që megjithatë përbën më pak se 20 për qind të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës.<sup>6</sup> Shkalla e ulët e vijimit të arsimit parafillor është problematikë edhe në rastin e nxënësve nga radhët e komunitetit shumicë në komuna të caktuara, por nga viti 2016 e tutje janë raportuar ngritje të vogla.<sup>7</sup> Krahasimet e shkallëve të shkrim-leximit të komuniteteve të caktuara shpalosin mospërputhjen ndërmjet komuniteteve shumicë dhe atyre joshumicë. Krahasuar me rreth 98 për qind të popullsisë së gjithmbarshme që di shkrim-lexim, vetëm 64 për qind e grave, dhe rreth 81 për qind e burrave romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës të moshës 15-49 vjeç dinë të lexojnë dhe të shkruajnë.<sup>8</sup> Shkaktarë kryesorë të kësaj shkalle të ulët të arritshmërisë në shkollim janë

2 Këshilli i Evropës, "Udhëzime për mësimdhënësit për përfshirjen sociale të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shkolla", 2015, f. 7; gjendet tek: <https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Guidelines-for-teachers-En.pdf/23d76fe4-66d2-4aae-8437-cfcec6bd64d5b>

3 Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat e arsimit në Kosovë" 2019/20, qershor 2020, f. 31.

4 Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i popullsisë dhe banesave të Kosovës 2011 – Rezultatet përfundimtare, 2012, në dispozicion në [http://ask.rks-gov.net/media/2075/final-results\\_eng.pdf](http://ask.rks-gov.net/media/2075/final-results_eng.pdf), f. 143, të dhënat e fundit zyrtare për përfaqësimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës të regjistruar në regjistrimin e vitit 2011, tregojnë se në Kosovë jetojnë 8,824 romë, 15,436 ashkali dhe 11,524 egjiptianë të Kosovës. Kështu, romët përbëjnë 0.51 për qind të popullsisë në Kosovë, ashkalitë 0.89 për qind dhe egjiptianët 0.66 për qind. Megjithatë, këto shifra nuk paraqesin pasqyrën e saktë demografike të këtyre tri komuniteteve, meqë në regjistrim nuk morën pjesë të gjithë pjesëtarët e tyre dhe regjistrimi nuk është realizuar në katër komuna veriore.


5 Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat e arsimit në Kosovë" 2019/20, Qershor 2020, f. 28; gjendet tek: <https://ask.rks-gov.net/media/5637/education-201902020-ang.pdf>

6 UNICEF, "Zhvillimi në fëmijërinë e hershme – Pasqyrë statistikore: Të dhënat për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian" f. 4; gjendet tek: [https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/196/file/ECD\\_Roma\\_Ashkali\\_and\\_Egyptian\\_communities\\_ENG.pdf](https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/196/file/ECD_Roma_Ashkali_and_Egyptian_communities_ENG.pdf)

7 KEEN, "Edukimi parashkollor në Kosovë", 2018, f. 24, gjendet tek: [http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Edukimi-parashkollor-në-Kosovë\\_ENG.pdf](http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Edukimi-parashkollor-në-Kosovë_ENG.pdf)

8 UNICEF, "Anketa e grupimeve të treguesve të shumfjshhtë 2019-2020 për Kosovë dhe Anketa e grupimeve të treguesve të shumfjshhtë 2019-2020 për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë Raporti i gjetjeve të anketës, nëntor 2020", f. 70-74, gjendet tek: <https://bit.ly/3xweeio>





kushtet e rënda socioekonomike, si dhe rolet gjinore që mbizotërojnë në radhët e këtyre komuniteteve. Shpeshherë, fëmijët detyrohen të punojnë për t'u ndihmuar familjeve të tyre, ndërkohë që tek vajzat faktor tjetër me ndikim negativ janë martesat e hershme.<sup>9</sup> Indeksi i barazisë gjinore për arsimin fillor për të tre komunitetet është 1.01, që tregon se më shumë vajza se djem vijnë shkollën fillore. Ky indeks shënon rënie të mëtejme në shkollë të mesme. Në arsimin e mesëm të ulët indeksi është 0.94, kurse në atë të mesëm të lartë indeksi është 0.80, që tregon se më pak vajza e vazhdojnë ose përfundojnë shkollimin.<sup>10</sup>

Shkalla shumë e ulët e vijimit të shkollimit dhe arritjet e kufizuara akademike gjegjëse të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në kontekst të mospërfshirjes sociale ishin arsytet që çuan në iniciativën e OJQ-ve për themelimin e QM-ve në vitin 2001, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të mësimin plotësues.<sup>11</sup>

Që atëherë, QM-të kanë luajtur rol të rëndësishëm në uljen e shkallës së braktisjes së shkollimit<sup>12</sup> dhe kanë ndikuar pozitivisht në rezultatet e të nxënimit (shkrim-lexim, nota) të fëmijëve, duke i inkurajuar ata që ta vazhdojnë shkollimin.<sup>13</sup> Edhe nga prindërit është raportuar nivel pozitiv kënaqshmërie, pasi ata kanë nënvizuar rëndësinë e QM-ve.<sup>14</sup>

QM-të, si model plotësues i zhvillimit dhe edukimit, kanë një synim të përbashkët, atë të mbajtjes së fëmijëve në shkollë, lehtësimin të pjesëmarrjes së tyre në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, si dhe arritjen e rezultateve më të mira të të nxënimit.<sup>15</sup> Përveç shërbimeve për fëmijë të moshës shkollore, disa QM ofrojnë edhe shërbime parashkollore/kopshti. Në përgjithësi, ato ofrojnë mbështetje për detyrat e shtëpisë, mësim plotësues dhe shkrim-lexim bazik për fëmijët të cilët nuk janë regjistruar kurrë në shkollë. Shumica e QM-ve veprojnë brenda objekteve shkollore, ku u sigurohet hapësirë pune nga komuna, ndërkaq pjesa tjetër janë të vendosura nëpër komunitetet të cilave u shërbejnë.<sup>16</sup> QM-të me bazë në komunitet kanë më shumë fleksibilitet me aktivitetet jashtëshkollore si kampet verore dhe mund të ofrojnë materiale edukative dhe ushqim, kurse QM-të me bazë në shkollë kanë një bashkëpunim më të mirë me mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave. Zakonisht, punonjësit e QM-ve

---

9 KOSINT 2020, "Ndikimi i qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim", 2018, f. 17. Gjetet tek [http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove\\_eng.pdf](http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove_eng.pdf)

10 Po aty fq.16.

11 Po aty fq. 18.

12 Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2018*, SWD (2018) 156 final, prill 2018, f. 27, në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>, dhe Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2020*, SWD (2020) 356 final, tetor 2020, f. 85; në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)


13 Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, f. 42-43; gjendet tek: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/blog/strategy-for-inclusion-of-roma-and-ashkali-communities-in-the-kosovo-society-2017-2021-11-05-2017/>

Shih po ashtu: CoE/UNICEF, "Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore", f.7.

14 Këshilli i Evropës/UNICEF, "Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore", 2015, f.7.

15 Po aty, faqet. 7; 11.

16 Nga gjithsej 47 QM aktive në prill 2022, 34 janë me bazë në shkollë ndërsa 13 janë me bazë në komunitet.



(koordinatorët/lehtësuesit/mësimdhënësit dhe vullnetarët) nuk kanë kualifikime në fushën e edukimit për shkak të karakterit joformal të këtyre qendrave.<sup>17</sup>

QM-të priren t'i synojnë zonat jo-përfituese dhe fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë për të pasur sukses dhe për të vazhduar shkollimin. Shkollat në zona të tilla zakonisht nuk janë të pajisura mjaftueshëm dhe janë të mbingarkuara. Në vitin 2018, më shumë se 5,500 fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta kanë qenë duke vijuar mësimin plotësues që ofrohet si nga QM-të me bazë në komunitet ashtu ato edhe me bazë në shkollë. Megjithatë, në vitin 2022, si rrjedhim i pandemisë dhe mbylljes së QM-ve, ky numër ka rënë në thuajse 3,000.<sup>18</sup>

QM-të janë promovuar si qendra në shërbim të kryesisht komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, megjithatë, me kalimin e viteve ato i kanë zgjeruar shërbimet edhe për fëmijë nga radhët e komuniteteve tjera. Rëndësia e vazhdimit të punës së QM-ve është theksuar edhe në Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, ku thuhet se QM-të duhet të gëzojnë mbështetje të veçantë për të paktën pesë vitet e ardhshme, deri në ngritjen e përgjithshme të nivelit arsimor dhe standardit jetësor të këtyre komuniteteve.<sup>19</sup> Ngjashëm, Strategjia e arsimit e Kosovës 2022-2026 dhe Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkali 2022 - 2026 pohojnë se QM-të zvogëlojnë numrin e nxënësve që braktisin shkollën, gjersa Plani gjegjës i veprimit (2022 - 2024) premtion 200,000 € për tre vitet e ardhshme.<sup>20</sup>

Vlera e QM-ve i tejkalon suazat e mbështetjes për fëmijët, ngaqë nga to përfitojnë dhe familjet e fëmijëve që i vijnë QM-të, shkollat e tyre, punëdhënësit e mundshëm dhe komunitetet lokale, dhe ato kontribuojnë në shëndet, shoqëri dhe ekonomi. Hulumtimet afatgjata nga vendet e zhvilluara tregojnë se shpenzimet publike për përkujdesje dhe edukimin e hershëm të fëmijëve janë investim i shëndoshë me përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale. Gjetjet e këtyre hulumtimeve tregojnë se një përjasje e tillë kontribuon në rritje ekonomike, rritje të mjeteve që shkojnë në thesar, si dhe sjell dobi shoqërore të tilla si një shoqëri më e arsimuar dhe nivel më i ulët krimi.<sup>21</sup> QM-ve duhet t'u njihet vlera në kuptimin e këtyre dobive të mëdha e afatgjata, dhe qëndrueshmëria e tyre të shihet si investim në të mirë të ekonomisë dhe shoqërisë në të ardhmen.

---

17 KOSINT 2020, "Ndikimi i qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim", 2018, f. 24.

18 Bazuar në hulumtimin e realizuar nga ekipet në terren të OSBE-së në prill të vitit 2022.

19 Strategjia për përfshirjen e komunitetit romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, f. 33.

20 Strategjia për avancimin e të drejtave të komunitetit romë dhe ashkali (2022-2026) f. 29 dhe Plani i veprimit f. 81

21 Aleanca për të Drejtat e Fëmijëve, "Themelet e rritjes - Investimi në gjeneratën e ardhshme", Avancimi i Kujdesit dhe Edukimit të Hershëm të Fëmijëve, gjendet tek

[https://www.childrensrights.ie/sites/default/files/submissions\\_reports/files/StartStrong\\_FoundationsOfGrowth.pdf](https://www.childrensrights.ie/sites/default/files/submissions_reports/files/StartStrong_FoundationsOfGrowth.pdf)

## 1.2 Rruga drejt institucionalizimit

Deri në vitin 2017, QM-të kanë funksionuar jashtë kornizave zyrtare të arsimit në Kosovë meqë veprimtaria e tyre nuk ka qenë e rregulluar me ligj. Struktura, funksionimi dhe programet arsimore të QM-ve mund të përshkruhen si të larmishme dhe me dallime nga një OJQ tek tjetra, për shkak të përjasjeve të ndryshme ndaj menaxhimit dhe të kërkesave të përcaktuara nga donatorë të ndryshëm.<sup>22</sup> Përveç mungesës së një qasjeje të unifikuar, ku kualifikimet dhe niveli i përgatitjes së personelit mësimdhënës dallojnë nga një QM në tjetrën, zyrtarë komunalë, mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave vënë ngandonjëherë në pikëpyetje edhe vetë efektivitetin e QM-ve.<sup>23</sup>

Si rrjedhojë e nevojës për qëndrueshmëri<sup>24</sup> dhe për qasje të harmonizuara, OJQ të ndryshme u bënë bashkë në vitin 2015 dhe e hartuan udhëzimin e parë administrativ për QM-të. MASHTI e miratoi **Udhëzimin administrativ nr. 12/2017 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore** (në tekstin e mëtutjeshëm UA nr. 12/2017), që parashihte licencimin e QM-ve të themeluara dhe administruara nga subjekte me status juridik.<sup>25</sup> Për më tepër, krahas financimit nga donatorët, ai përcaktonte obligimin e qeverisë dhe komunave për të ndarë fonde për QM-të.<sup>26</sup> UA nr. 12/2017 ishte një hap para në procesin e harmonizimit të punës së QM-ve dhe parashihte **detyrimin për institucionet publike që t'i mbështesin ato financiarisht**. Në dhjetor të vitit 2018, UA nr. 12/2017 u zëvendësua me **Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore** (në tekstin e mëtutjeshëm UA 19/2018), që ishte më i përplotësuar.

UA nr. 19/2018 përcakton standardet minimale të njësuara për funksionimin e QM-ve, përfshirë lidhur me planprogramet e miratuara, kualifikimet e personelit, planifikimin e qëndrueshëm të buxhetit, si dhe vlerësimin dhe raportimin. Bashkë me Udhëzuesin praktik,<sup>27</sup> ai u ofron QM-ve një pasqyrë të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që kërkohet për ta regjistruar një QM. Kjo përbën përparim të rëndësishëm në procesin e inkorporimit të QM-ve në kornizën e arsimit formal, duke i vendosur QM-të nën ombrellën e MASHTI-t dhe komunave, të cilave u japin llogari. Përkundër këtij zhvillimi pozitiv, vazhdon akoma të ketë vonesa të institucioneve qeveritare dhe komunale në

22 Këshilli i Evropës/UNICEF, "Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore", 2015, f. 13; 24; 26.


23 Këshilli i Evropës/UNICEF, "Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore", 2015, f. 40.

24 Ambasadori i Norvegjisë në Prishtinë: "Fondet po pakësohen, këto qendra bazohen vetëm në ndihmën e donatorëve. Nëse qeveria nuk ndërhyr dhe nuk i merr ato nën kompetencat e tyre, do të jetë shumë e vështirë për këto QM të jenë të qëndrueshme." Shih: Këshilli i Evropës, UNICEF, "Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore", 2015, f. 38; gjendet tek: [https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Study\\_on\\_Impact\\_and\\_Sustainability\\_of\\_the\\_Learning\\_Centers-En.pdf/4a76eefe-21d0-432c-800c-ad24a2f7](https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-En.pdf/4a76eefe-21d0-432c-800c-ad24a2f7).

25 Udhëzimi administrativ nr. 12/2017 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, nenet 7 dhe 8.

26 UA nr. 12/2017, neni 10(1).

27 Udhëzues praktik për zbatimin e Udhëzimit administrativ mbi themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore me nr. 19/2018, në gjuhën shqipe: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/12/udhezues.pdf>



përmbushjen e obligimeve karshi QM-ve. Gjersa UA ishte zhvillim i mirëpritur nga akterë të ndryshëm,<sup>28</sup> vonesat në zbatimin e tij lënë të kuptohet se kalimi i QM-të nën kompetencën e institucioneve komunale dhe qeveritare nuk është arritur akoma. Veç kësaj, QM-të vazhdojnë të përballen me mungesë financimi, dhe mbylljet janë dukuri e përhapur.

## Metodologjia

Në periudhën shkurt 2020 - prill 2022, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka kontaktuar tri herë radhazi më se 90 QM qoftë funksionale ose joaktive a të mbyllura, duke u kërkuar informata rreth punës, statusit të financimit dhe regjistrimit në lidhje me zbatimin e UA nr. 19/2018. Në prill të vitit 2022 janë kontaktuar po ashtu dhe drejtoritë komunale të arsimit (DKA) të atyre komunave me QM aktive, për të mësuar më shumë rreth mbështetjes që u jepet QM-ve. Inputet nga Ministria e Arsimit janë siguruar përmes grupit punues OSBE – MASHTI.

Informatat e pranuar janë plotësuar më tej me hulumtime nga zyra, shqyrtim të dokumenteve dhe raporteve lidhur me QM-të. Veç kësaj, nëpërmjet videointervistave ose emailit, palëve të interesit të angazhuara në këtë drejtim u janë kërkuar përditësime në lidhje me ndryshimin e situatës që kur ka nisur regjistrimit.<sup>29</sup>

---

28 Deklaratë nga KOSINT2020, më 25 gusht 2017, gjendet tek: <https://kosint2020.net/en/news-and-events/approval-of-the-administrative-instruction-no-12-2017-on-the-establishment-dhe-funksionimi-e-qendrave-mësimore-nga-ministria/>

29 Bashkëbisedues ishin drejtorë të OJQ-ve, menaxherë programesh, donatorë, përfaqësues të MESTI-t dhe Zyra e BE-së në Kosovë.

## II. Realiteti i ri ligjor për qendrat mësimore: Udhëzimi administrativ nr. 19/2018

UA nr. 19/2018<sup>30</sup> përcakton kriteret dhe procedurat e themelimit dhe funksionimin e QM-ve, që ofrojnë mbështetje plotësuese dhe aktivitete të tjera edukativo-arsimore. Sipas UA nr. 19/2018, objektivat kryesore të QM-ve janë sa vijon:

- Zhvillimi fizik, kognitiv, emocional dhe social i fëmijëve/nxënësve.
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve/nxënësve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët.
- Përmirësimi i vijueshmërisë në shkollë dhe rezultateve të të nxënit.
- Zvogëlimi apo eliminimi i braktisjes së shkollimit.
- Përfshirja e shtuar e fëmijëve/nxënësve në aktivitete jashtë-mësimore.
- Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve/nxënësve.
- Përfshirja aktive e prindërve në edukimin e fëmijëve/nxënësve.
- Shtimi i mundësive për socializim të fëmijëve/nxënësve.<sup>31</sup>

Sipas UA nr. 19/2018, komunat dhe subjektet që kanë statusin e personit juridik kanë kompetencë për të themeluar dhe administruar QM, dhe të njëjtat duhet t'i regjistrojnë në MASHTI.<sup>32</sup> Më pas, MASHTI është përgjegjës për dhënie të lejes zyrtare me kohëzgjatje pesëvjeçare, kur bartësi i mundshëm i QM i plotëson kriteret e përcaktuara me UA 19/2018.<sup>33</sup>

Që t'i plotësojë kriteret bazë, aplikuesi duhet të ketë hapësirë fizike dhe mjedis pune të përshtatshëm, program për mësim plotësues, personel të kualifikuar, rregullore të punës dhe rregullore për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe një plan pune dhe plan financiar.<sup>34</sup> Këto kërkesa janë të rëndësishme për të siguruar funksionimin e sinkronizuar dhe të qëndrueshëm të QM-ve të ardhshme. Aspekt tjetër i rëndësishëm i UA nr. 19/2018 është se ai përcakton kualifikimet e nevojshme për personelin dhe, në veçanti, vendos kriteret të përgatitjes minimale akademike për koordinatorët dhe personelit mësimdhënës të

---


30 Ky UA është nxjerrë në mbështetje të nenit 4, 21 dhe 22 të ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Kosovës, nenit 5, paragrafi 16 të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Kosovë, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe shtojcës 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushën e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011). Në shkurt të vitit 2022, ZKM publikoi një shqyrtim ligjor të të gjitha akteve nënligjore për këtë sektor përkatës që janë zbatuar, me qëllim të vlerësimit të efektivitetit të tyre. Për sa i përket Udhëzimit administrativ nr. 19/2018 është konstatuar se nuk ka bazë konkrete ligjore për nxjerrjen e këtij udhëzimi administrativ. Megjithatë, për të shmangur vakuumin ligjor në këtë fushë, është rekomanduar që i njëjti të mbetet në fuqi deri në krijimin e një baze konkrete ligjore për nxjerrjen e tij.

31 Udhëzimi administrativ (UA) 19/2018, neni 3, paragrafi 7.

32 UA nr. 19/2018, neni 3, paragrafët 1-3.

33 UA nr. 19/2018, neni 3, paragrafi 2 dhe neni 4, paragrafët 1 dhe 5.

34 UA nr. 19/2018, neni 5, paragrafi 1.



QM-ve<sup>35</sup>, e që është vendimtare për ofrimin e arsimit cilësor. Personeli ekzistues i QM që nuk i plotëson kriteret e përcaktuara do të ketë pesë vjet afat për t'i fituar kualifikimet.<sup>36</sup>

Sa i përket financimit, QM-të do të financohen nga dy burime kryesore: buxheti i Kosovës (qeveritar dhe komunal); dhe donacionet e jashtme, të cilat mund t'u jepen drejtpërsëdrejti bartësve<sup>37</sup> të QM-ve ose në buxhetin e Kosovës të dedikuar për shfrytëzim nga QM-të.<sup>38</sup> MASHTI është përgjegjës për planifikimin e buxhetit vjetor për QM-të; duke siguruar që financimi i programit të QM të jetë në përputhje me rregulloren e qeverisë; dhe planifikimin e mbështetjes së veçantë në shpalljen publike për financimin e projekteve përmes kategorisë<sup>39</sup> së subvencioneve. Komuna, kur i kërkohet nga QM-të, është e obliguar të përfshijë mbështetjen financiare në buxhetin vjetor dhe, nëpërmjet granteve të veçanta, të planifikojë buxhetin bazë/fillestar për themelimin dhe funksionimin e QM-ve në shkolla.<sup>40</sup> Komunat janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e hapësirës për QM-të me bazë në komunitet dhe mbulimin e kostos operacionale.<sup>41</sup> QM-të e drejtuara nga OJQ-të i përgjigjen MESTI-t dhe drejtorisë komunale për arsimin (në tekstin vijues DKA). Llogaridhënia përfshin edhe detyrën për bartësin e QM-së të dorëzojë raporte vjetore narrative dhe financiare në MESTI dhe DKA-të përkatëse. Nga ana tjetër, MESTI është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e punës së QM dhe komuna është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e QM dhe mbikëqyrjen në përzgjedhje të personelit.<sup>42</sup>

UA 19/2018 përbën mjet jetik për krijimin e sistemit efektiv, të qëndrueshëm dhe transparent të QM-ve duke paraqitur kërkesa të përbashkëta, si dhe duke ngarkuar MASHT-in dhe DKA-të për monitorim dhe raportim.<sup>43</sup>

Miratimi i UA 19/2018 dha shpresa të mëdha për një kalim të qetë nga qasjet operacionale të fragmentuara dhe varësia nga donatorët drejt një mjedisi më të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, të bazuar në financim buxhetor. Kështu ishte paraparë pjesërisht institucionalizimi, përmes përmirësimit të menaxhimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes. Megjithatë, paqartësia lidhur me shumatat reale të financimit dhe kanalet e qëndrueshme të financimit nuk i përshtatet vizionit për institucionalizim.

---

35 UA nr. 19/2018, neni 8, paragrafi 2.1, Koordinatorët e QM duhet të kenë të paktën kualifikim të nivelit Bachelor dhe paragrafi 4.1, Personeli mësimdhënës i QM duhet të ketë kualifikim për mësimdhënie.

36 UA nr. 19/2018, neni 14, paragrafi 2.

37 UA 19/2018, neni 2, Përkufizimet, Bartësit – njësitë që themelojnë dhe menaxhojnë qendrat mësimore, si dhe institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen e punëve në to.

38 UA 19/2018, neni 13, paragrafi 1

39 UA 19/2018, neni 13, paragrafi 2

40 UA 19/2018, neni 13, paragrafi 3

41 UA 19/2018, neni 11 paragrafi 3

42 UA 19/2018, neni 11, paragrafi 3 dhe 4

43 UA 19/2018, neni 12

## 2.1 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/2018

Pas miratimit të UA 19/2018 në dhjetor 2018, pritej që brenda tre muajve të publikohej Udhëzuesi Praktik për funksionimin e QM-ve<sup>44</sup>. Udhëzuesi Praktik për Funksionimin e Qendrave Mësimore në mbështetje të zbatimit të UA 19/2018 (në tekstin e mëtejshëm Udhëzues Praktik) nuk u publikua deri pothuajse një vit më vonë, në fund të vitit 2019. Kjo vonesë pati pasoja të rënda për institucionalizimin e QM-ve, gjë që çoi në huti se si të vazhdohej më tej me regjistrimin dhe krijoi pakënaqësi në mesin e OJQ-ve që menaxhojnë QM-të ekzistuese.

Shumë nga detyrat e që kërkonin veprim në UA 19/2018 ishin të lidhura me referenca nga Udhëzuesi Praktik.<sup>45</sup> Nga QM-të pritej ti përmbushin kërkesat jo më vonë se 12 muaj pas hyrjes në fuqi të UA 19/2018; dhe pajtueshmëria me këtë ishte vendosur si kusht prej disa donatorëve.<sup>46</sup> Megjithatë, pajtueshmëria u bë praktikisht e pamundur pa udhëzime konkrete.

Faqja për regjistrim u funksionalizua në shtator 2020 (me vonesa që i atribuohen pandemisë COVID-19). Pasi të ngarkohet dokumentacioni për regjistrim, MASHTI ka tre muaj nga data e aplikimit për të nxjerrë vendim.<sup>47</sup> Për QM-të me bazë në komunitet kërkohej vizita në terren dhe, duke pasur parasysh kufizimet gjatë pandemisë, procesi në praktikë ka zgjatur më shumë.

Që nga prilli i vitit 2022, shtatë OJQ i kishin regjistruar disa ose të gjitha QM-të nën menaxhimin e tyre, duke arritur në 37 QM, ndonëse disa prej këtyre QM-ve që atëherë kanë ndaluar ose ndërprerë aktivitetet për shkak të problemeve me financimin. OJQ VoRAE po ndihmon DKA-të ku QM-të e tyre janë aktive për t'i regjistruar ato. Sipas MASHTI-t, deri më tani, asnjë QM nuk është refuzuar.

Nga 37 QM të regjistruara, vetëm 13 kanë marrë leje për pesë vite të plota, ndërsa shumica kanë leje të kushtëzuara nga dy deri në tre vjet. Lejet me gjatësi të kufizuar varen nga përmirësimet që do bëhen në funksionimin e QM-së, e këto kërkojnë fonde të konsiderueshme dhe nuk po përmirësohen për të arritur standardin. Ndërkohë që 41 kanë aplikuar për regjistrim, 23 QM aktive nuk e kanë bërë këtë. Arsyet e tyre për mosregjistrim dallojnë. Disa janë të vetëdijshme se nuk i plotësojnë kriteret sa i përket


---

44 UA 19/2018, neni 12, paragrafi 1.

45 UA 19/2018 i referohet Udhëzuesit praktik për regjistrimin (neni 7, paragrafi 3) planin e punës dhe financiar (neni 10 paragrafi 2), dhe udhëzuesin për raportimin, monitorimin dhe formën e raportimit të detajuar vjetor (neni 12, paragrafi 1)

46 Për shembull, përmbushja e kriterëve të përcaktuara në UA 19/2018 ishte një nga parakushtet e Agjencisë Austriake për Zhvillim për t'i dhënë 21,000 € financim OJQ "The Ideas Partnership" (TIP), në veçanti, infrastrukturën e përhershme dhe funksionale, harmonizimi i kurrikulës së Kosovës me aktivitetet e qendrave dhe stafit të kualifikuar. Shih: Misioni i OSBE-së në Kosovë, Qendra Rajonale Prishtinë, bashkëbisedues: Menaxher i Programit të OJQ TIP

47 UA 19/2018, neni 4, paragrafi 2.



personelit apo hapësirës dhe po përpiqen ti arrijnë standardet minimale përpara se të aplikojnë. Të tjerat presin derisa të përfundojë mbështetja e tyre aktuale nga donatorët. Këto ose nuk mbështeten nga DKA-të e tyre ose nuk kanë komunikuar fare me ato.<sup>48</sup> Pas regjistrimit, sipas UA 19/2018, QM-të duhet të raportojnë në MASHTI, por për këtë gjë nuk ka asnjë kornizë të krijuar. Disa DKA hezitojnë të nënshkruajnë memorandume mirëkuptimi (MM) me QM-të pasi janë të vetëdijshme se nuk kanë linjë buxhetore për të paguar personelin e QM-ve. Dy QM në rajonin e Mitrovicës Jugore kishin nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me komunën për bartjen graduale të përgjegjësisë, por pastaj u tërhoqën MM-të dhe rrjedhimisht aplikimi, pasi nuk kishin buxhet për të respektuar marrëveshjen.<sup>49</sup> Vonesat e gjata dhe mungesa e komunikimit të qartë ndërmjet MASHTI-t, DKA-ve dhe QM-ve kanë kontribuar në zbatim jokonsistent dhe me ndërprerje të UA 19/2018.

Obligimet tjera të MASHTI-t të përcaktuara në UA 19/2018 ende nuk janë përmbushur. Këto përfshijnë programe trajnimi që do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me Universitetin e Prishtinës dhe zhvillimin e një vlerësimi sistematik të aktiviteteve të QM-ve.<sup>50</sup>

### III. Funkcionimi dhe financimi i qendrave mësimore

Që nga fundi i prillit 2022, ekipet në terren të OSBE-së kishin kontaktuar 47 QM operative dhe 53 QM rishtas të mbyllura ose joaktive në 17 komuna.<sup>51</sup> Rajoni i Prishtinës ka numrin më të madh të QM-ve aktive, ndjekur nga rajoni i Pejës dhe i Prizrenit (shih Tabelën 1).<sup>52</sup>

47 QM-të që funksionojnë aktualisht menaxhohen nga 13 OJQ vendore dhe ndërkombëtare.

Lidhur me UA 19/2018, TdH dhe VoRAE kanë nënshkruar memorandume mirëkuptimi me komunat ku operojnë për të realizuar bartjen graduale të përgjegjësisë financiare për ato

---

48 Dhjetë QM Operacionale nuk kanë MM të nënshkruara me komunë.


49 Dy QM në rajonin e Mitrovicës Jugore janë aktualisht duke kërkuar mënyra me DKA për të zgjidhur problemin meqë të dyja QM-të kanë pezulluar aktivitetet që nga shtatori 2020.

50 Intervistë e Misionit të OSBE-së në Kosovë përmes postës elektronike me Shefin i Divizionit për Arsimit të Komuniteteve, MASHTI.

51 Komunitat ku QM janë aktive që nga prilli 2022: Prizren (5), Suharekë (4), Rahovec (1), Gjiçan (1), Novobërdë (1), Ferizaj (4), Mitrovicë Jugore (1), Vushtrri (3), Podujevë (2), Gjakovë (3), Pejë (2), Istog (5), Graçanicë (2), Fushë Kosovë (2), Shtime (3), Obiliq (3), Lipjan (5).

52 Shih Tabelën 1 në fund të këtij raporti për OJQ-të që menaxhojnë Qendrat Mësimore në 2021 dhe 2022.





QM tek DKA-të. Ky pranim-dorëzim i nënshtrohet një periudhe kalimtare tre vjeçare, gjatë së cilës periudhë fondet nga OJQ-të zvogëlohen sa kohë që rriten fondet komunale.

Agjencia Gjermane për Zhvillim, "Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)", mes tjerash, ndërpreu financimin për më shumë se 20 QM në mbarë Kosovën në fund të vitit 2019, kur përfunduan projektet e tyre. Ajo kishte luajtur rol thelbësor në avokimin për institucionalizimin e QM-ve dhe, kur MASHTI nuk ndau fonde për QM-të siç ishte premtuar në vitin 2020, ajo kontraktoi OJQ-në Edu Task për të krijuar dhe funksionalizuar 20 QM në shkolla. Financimi nga GIZ për këto qendra të reja pushoi në shkurt 2021, por disa shkolla kanë zgjedhur të vazhdojnë programet dhe tani po kërkojnë mbështetje komunale. Në mars 2021, Këshilli i Evropës vuri në dispozicion 60,000 € për QM-të nga prilli deri në nëntor 2021 dhe nuk kërkoi nga ato që të regjistroheshin në MASHTI për të aplikuar.<sup>53</sup>

Fatkeqësisht, 53 QM janë mbyllur që nga viti 2018, ku shumica e tyre u mbyll në vitin 2021<sup>54</sup>, ndërsa të tjerave iu desh të ulin numrin e aktiviteteve ose të personelit në vitin e fundit (shih Tabelën 1). Disa QM raportuan se pagat ishin ulur për shkak të mjeteve të kufizuara financiare, ndërsa disa mësimdhënës treguan se kishin marrë vetëm 50 për qind të pagës së tyre që nga qershori 2019.<sup>55</sup> Mbylljet ishin të pashmangshme pasi donatorët kryesorë, si GIZ dhe projekti EU SIMRAES II i kishin planifikuar financimet e tyre përkatëse në përputhje me zbatimin e pritshëm të UA 19/2018.

**Në rajonin e Prizrenit**, aktualisht funksionojnë dhjetë QM me bazë në shkolla: pesë në komunën e Prizrenit, katër në Suharekë dhe një në Rahovec, me shërbime të ofruara për 451 nxënës, 245 vajza dhe 206 djem.<sup>56</sup> Katër QM kanë qenë të suksesshme në marrjen e lejeve nga MASHTI.<sup>57</sup> Gjashtë qendrat tjera nuk janë regjistruar në MASHTI. Krahas tyre, njëmbëdhjetë QM u mbyllën në rajonin e Prizrenit mes viteve 2019 dhe 2021 për shkak të mungesës së fondeve.<sup>58</sup>

Bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe QM-ve në rajonin e Prizrenit në përgjithësi vlerësohet si mjaft i mirë - nëntë nga dhjetë QM kanë MM të nënshkruara me komunën dhe një është në pritje që nga janari 2022. Këto memorandume përfshijnë sigurimin, gjegjësisht ofrimin e hapësirës dhe mbulimin e shërbimeve komunale në QM-të me bazë në shkolla. Në rastet ku DKA-ja ka marrë përgjegjësinë për të paguar personelin, pagesat ndonjëherë u vonohen. Është raportuar gjithashtu se disa DKA nuk janë në dijeni se çfarë përbën një QM dhe sa prej tyre janë nën kompetencën e tyre. Asnjë nga tre komunat me

---

53 Sipas thirrjes, katër (4) organizata të shoqërisë civile mund të aplikojnë për shumë deri në 15,000 € secila për të mbuluar tre (3) QM deri në nëntor 2021, thirrja në dispozicion këtu [https://rm.coe.int/call-for-proposals-supporting-learning-centres-through-small-grant-sch/naive/1680a18f45#\\_Toc63844867](https://rm.coe.int/call-for-proposals-supporting-learning-centres-through-small-grant-sch/naive/1680a18f45#_Toc63844867)


54 Bazuar në informacionin që i është siguruar QR-ve përmes pyetësorëve në prill 2021 dhe prill 2022.

55 Raportuar nga QM-të në rajonin e Mitrovicës dhe Gjilanit

56 QM-të në rajonin e Prizrenit menaxhohen nga OJQ Nevo Koncepti (5), VoRAE (4) dhe Terre des Hommes (1).

57 Dy në Suharekë, një në Rahovec dhe një në Prizren.

58 Në komunën e Prizrenit katër QM me bazë në shkolla të menaxhuara nga Nevo Koncepti dhe të financuara nga GIZ u mbyllën më 31 dhjetor 2019, tre të tjera u mbyllën në dhjetor 2020. Dy QM të drejtuara nga EDU TASK dhe ADEC u mbyllën në mars 2021. Dy QM të menaxhuara nga Schuler Helfen Leben, në Rahovec u mbyllën në shtator 2019.



QM funksionale nuk kanë linja buxhetore të dedikuara për pagat e personelit të QM; në vend të kësaj, pagesat përfshihen tek marrëveshjet afatshkurtra mbi vepër.

**Në rajonin e Prishtinës**, që në prill 2022, 15 QM ishin funksionale (gjashtë me bazë në komunitet dhe nëntë me bazë në shkollë): gjashtë në Lipjan, tre në Shtime, tre në Obiliq, dy në Fushë Kosovë dhe dy në Graçanicë, me shërbime të ofruara për 1,394 nxënës, 795 vajza dhe 599 djem.<sup>59</sup> Trembëdhjetë QM janë regjistruar në MASHTI dhe kanë marrë leje, ndërsa dy nuk kanë aplikuar ende. Nëntë QM janë mbyllur në vitin 2021 dhe 2022, si dhe një në vitin 2017.<sup>60</sup> Pas këtyre mbylljeve, nuk ka mbetur asnjë QM funksionale në komunën e Prishtinës.

Bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe QM-ve në rajonin e Prishtinës në përgjithësi vlerësohet si i mirë - 12 nga 15 QM-të operative kanë nënshkruar MM me komunën përkatëse. QM me bazë në shkollë gëzojnë një bashkëpunim më të mirë se QM me bazë në komunitet. Dispozitat e Memorandumit të Mirëkuptimit përfshijnë sigurimin e hapësirës dhe mbulimin e shërbimeve komunale (ose sigurimin e druve të zjarrit në rastin e QM-ve me bazë në komunitet). Disa DKA kanë raportuar gabimisht për numrin e QM që operojnë në zonën e tyre, duke shfaqur mos-vetëdijesim për mbylljet e fundit. Asnjë nga tre komunat me QM funksionale me bazë komuniteti nuk ka linjë buxhetore të dedikuara për QM-të.

**Në rajonin e Pejës**, në prill 2022 kishte dhjetë QM funksionale (tre me bazë në komunitet dhe shtatë me bazë në shkollë): dy në Pejë, tre në Gjakovë dhe pesë në Istog.<sup>61</sup> Katër QM i kanë siguruar me sukses lejet nga MASHTI, ndërsa gjashtë nuk kishin aplikuar. Nga marsi 2019 deri në mars 2022, 22 QM u mbyllën për shkak të mungesës së fondeve.<sup>62</sup> Që nga nëntori i vitit 2021, Komuna e Klinës nuk ka QM funksionale.

Bashkëpunimi ndërmjet QM-ve dhe DKA-ve në komunat e rajonit të Pejës është mjaft i mirë, edhe pse vetëm katër nga dhjetë QM-të kanë nënshkruar memorandum. Komunat ofrojnë hapësirë dhe mbulojnë disa shërbime komunale. DKA-të në rajonin e Pejës nuk kanë linjë të dedikuara buxhetore për QM-të dhe ende nuk janë zotuar për mbulimin e pagave.


---

59 QM-të në rajonin e Prishtinës menaxhohen nga VoRAE (6), Balkan Sunflowers Kosova (5), The Ideas Partnership (2) Romani Iniciativa Hak (1) dhe EDU Task (1).

60 Në komunën e Prishtinës dy QM me bazë në shkollë që menaxhoheshin nga TdH u mbyllën në janar 2022, ndërsa gjashtë QM me bazë në shkollë që menaxhoheshin nga EDU Task dhe ADEC u mbyllën në korrik 2021. Në komunën e Shtimes dy QM me bazë në shkollë u mbyllën në shkurt 2021, ndërsa në Lipjan një QM e menaxhuar nga VoRAE u mbyll në 2017.

61 Në rajonin e Pejës tre (3) QM menaxhohen nga Terre des Hommes, dy (2) nga Syri i Vizionit, tre (3) OJQ Vizioni 02, një (1) nga Bethany Christian Services dhe një (1) nga Caritas Kosova.

62 Në komunën e Gjakovës janë mbyllur tetë (8) QM me bazë shkollë të menaxhuara nga Bethany Christian Services, (2) të menaxhuara nga EDU TASK dhe ADEC. Në komunën e Pejës janë mbyllur gjashtë (6) QM me bazë shkollë të menaxhuara nga TdH dhe tre (3) nga OJQ Syri Vizionit. Në komunën e Klinës pesë (5) QM me bazë në shkollë janë mbyllur dhe në komunën e Istogut janë mbyllur tre (3) QM me bazë në shkollë.



**Në rajonin e Gjilanit**, në prill 2022 kishte gjashtë QM funksionale (dy me bazë në komunitet dhe katër me bazë në shkolla): katër në Ferizaj, një në Gjilan dhe një në Novobërdë, duke ofruar shërbime për 383 nxënës, 206 vajza dhe 177 djem.<sup>63</sup> Katër QM janë regjistruar dhe kanë marrë leje nga MASHTI, ndërsa dy të tjerat nuk kanë aplikuar.<sup>64</sup> Mes dhjetorit 2018 dhe janarit 2020, pesë QM janë mbyllur për shkak të mungesës së financimit, duke e lënë Kamenicën pa asnjë QM funksionale.<sup>65</sup>

Bashkëpunimi ndërmjet komunave dhe QM-ve në rajonin e Gjilanit është shumë i mirë, ku të gjashtë QM-të funksionale kanë siguruar memorandume të nënshkruara me tri drejtoritë komunale të arsimit. DKA-të mbështesin QM-të me bazë në shkollë dhe në komunitet me hapësirë dhe mbulim të shpenzimeve operacionale. Aty ku janë bërë marrëveshje që DKA-të të marrin përsipër pagesën e personelit të QM-ve, ka çështje të vazhdueshme për tu zgjidhur meqë nuk ka një linjë specifike buxhetore për QM-të. Kjo mund të shkaktojë vonesa në pagesat e pagave dhe të dëmtojë bashkëpunimin.

**Në rajonin e Mitrovicës**, në prill 2022 kishte gjashtë QM funksionale (dy me bazë në komunitet dhe katër me bazë në shkolla): dy në Podujevë, një në Mitrovicë Jugore dhe tre në Vushtrri.<sup>66</sup> Katër QM kanë aplikuar për t'u regjistruar në MASHTI por nuk e kanë marrë lejen, dy të tjera nuk kanë aplikuar. Pesë QM në rajonin e Mitrovicës u mbyllën gjatë vitit 2021.<sup>67</sup>

Bashkëpunimi ndërmjet QM-ve dhe DKA-ve në rajonin e Mitrovicës është mjaft i mirë meqë të gjashtë QM-të funksionale kanë një MM të nënshkruar me komunën përkatëse. Komunitat ofrojnë hapësirë dhe mbulojnë kostot operative. Në rastet kur memorandumet e mirëkuptimit përfshijnë bartjen graduale të përgjegjësisë, çështjet që lidhen me financimin janë të rëndomta. Dy QM në Podujevë të menaxhuara nga VoRAE nuk kanë qenë plotësisht funksionale që nga shtatori 2020, pasi komuna nuk arriti të respektojë pjesë të një MM që lidhesh me financimin e qendrës.<sup>68</sup> Disa DKA gjithashtu kanë raportuar gabimisht për numrin e QM-ve që operojnë në zonën e tyre.

---

63 QM-të në rajonin e Gjilanit menaxhohen nga VoRAE – tre (3), nga Terre des Hommes – dy (2) dhe një (1) nga Caritas Kosova.

64 Katër QM në Ferizaj janë regjistruar në MASHTI.

65 Në dhjetor 2018, QM-ja në Gjilan që menaxhohej nga OJQ “Rrograek” (rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane) dhe financohej nga Save the Children u mbyll, ndërsa dy (2) të tjera nën menaxhimin e EDU TASK dhe ADEC u mbyllën në vitin 2021. Në janar 2020, QM e menaxhuar nga VoRAE në Kamenicë u mbyll, ndërsa një tjetër nuk është aktive.

66 QM-të në rajonin e Mitrovicës menaxhohen nga Terre des Hommes (2), VoRAE (2), Romano Anglunipe (1) dhe Këshilli Danez për Refugjatë (1).

67 Dy QM në Mitrovicë Jugore nën menaxhimin e TdH u mbyllën në shtator 2021 dhe tre QM në Podujevë gjithashtu u mbyllën në 2021.

68 QM Qëndrimi Shaban Shala dhe Qëndrimi Ibrahim Rugova në Podujevë i kanë ndërprerë aktivitetet për shkak të mos respektimit të Memorandumit të Mirëkuptimit nga komuna.

## Financimi

Si Strategjia e Arsimit e Kosovës 2022-2026, ashtu edhe Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali 2022 – 2026 dhe Plani i Veprimit (2022 – 2024) kanë të zotuar 200,000 € për qendrat mësimore për tre vitet e ardhshme.<sup>69</sup> Strategjia e dytë nga të lartpërmendurat kërkon krijimin e komiteteve të reja komunale të veprimit (KKK) dhe zhvillimin e planeve të reja lokale të veprimit (PLV). Përbërja e KKK-ve është thelbësore për të siguruar përfshirjen e mbështetjes për QM-të nga PLV-të. Megjithatë, është e qartë se ky financim nuk është i mjaftueshëm.

Bazuar në të dhënat e vitit 2018 nga “Iniciativa për Integrim në Kosovë 2020 - KOSINT”, buxheti vjetor për të gjitha QM-të ishte 1,807,750€, ndërsa shpenzimi mesatar vjetor i të gjitha QM-ve për student ishte 325€, që konvertohet në **27€ për student në muaj**.<sup>70</sup> Përgjatë viteve, organizatat donatore ndërkombëtare kanë qenë burimi kryesor i financimit,<sup>71</sup> ndërkohë që realiteti i ri ligjor tashmë i detyron fondet publike të përballojnë shpenzimet e tyre. Megjithatë, ky obligim nuk përcakton shumën e mbështetjes së kërkuar, qoftë në ministri apo në nivel komunal.


Disa donatorë po tërhiqen ose janë tërhequr tashmë nga financimi i QM-ve, ndërsa të tjerët kanë rënë dakord për një strategji daljeje me OJQ-të që i menaxhojnë QM-të, strategji kjo që parashikon një periudhë prej tre vjetësh gjatë së cilës financimi i donatorëve do të zvogëlohet proporcionalisht çdo vit. Sipas OJQ-së VoRAE, donatorët kanë kërkuar bartjen e QM-ve brenda një periudhë trevjeçare. OJQ VoRAE do të monitorojë dhe këshillojë administratën e re (komunale), ndërsa donatorët gradualisht zvogëlojnë fondet e tyre, derisa komunat t'i financojnë ato plotësisht.

Aktualisht, kontributet financiare nga komunat janë mjaft të kufizuara dhe nuk ofrojnë asistencën thelbësore të nevojshme për funksionimin e plotë të QM-ve. Vetëm disa komuna ofrojnë mbështetje financiare, përveç ndarjes për shfrytëzim të hapësirave apo klasave në shkolla, qoftë kjo ndihmë për kryerjen e aktiviteteve apo mbulimin e shpenzimeve komunale. Komunat e Lipjanit dhe Shtimes bashkëfinancojnë QM-të e operuara nga OJQ VoRAE, ndërsa komuna e Ferizajt financon 75 për qind të shpenzimeve

69 Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali (2022-2026) f. 29 dhe Plani i Veprimit f. 81

70 KOSINT 2020, “Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim”, 2018, f. 7 dhe 29.

71 Zyra e BE-së në Kosovë; Agjencia Gjermane për Zhvillim, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ); Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik (BMZ); Karl Kubel Stiftung für Kind und Familie (KKS); Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC); Ndihma e Kishës Zvicerane (HEKS/EPER); Këshilli Danez për Refugjatë (DRC); Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), DIAKONIE (Austri); UNICEF; Save the Children Fund; Njerëzit në nevojë; Fondi i Arsimit Rom.



për QM-në në Qendrën Sociale dhe Kulturore të Ashkalive, në fshatin Dubravë; dhe OJQ “Caritas Kosova” mbulon pjesën e mbetur prej 25 për qind të shpenzimeve.

Themelimi i QM-ve të reja dhe mbështetja e atyre ekzistuese ishin ndër objektivat e disa planeve lokale të veprimit (PLV) për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.<sup>72</sup> Komuna e Ferizajt parasheh themelimin e QM-ve, por kjo ende nuk është bërë.<sup>73</sup> Në komunën e Prizrenit, QM-të ishin themeluar në pesë shkolla; <sup>74</sup> megjithatë, DKA-ja nuk arriti të punësojë tetë mësimmhënës sipas planit strategjik.<sup>75</sup> PLV-të e komunave të Lipjanit dhe Graçanicës parashihnin përkrahje për QM-të përmes ofrimit të hapësirave të nevojshme dhe mbulimit të faturave komunale.<sup>76</sup> PLV-ja në komunën e Vushtrisë parashihte 2,000€ për mbështetjen e QM-së; megjithatë, drejtori i QM-së në fshatin Prelluzhë deklaroi se deri në atë moment nuk janë bartur fonde për aktivitetet e QM-së. Vitet e fundit janë nënshkruar një numër i madh i marrëveshjeve të mirëkuptimit ndërmjet OJQ-ve dhe institucioneve komunale, përmes të cilave institucionet komunale janë zotuar të ofrojnë hapësira shkollore për QM-të për të kryer aktivitetet e tyre. Megjithatë, këto MM nuk respektohen gjithmonë.<sup>77</sup>

Terre des Hommes dhe VoRAE kanë punuar në mënyrë proaktive me komunat dhe shkollat për të rritur kapacitetet e tyre për të administruar QM-të. Aty është konstatuar se DKA-të janë të interesuara për financimin e QM-ve. Megjithatë, shumë nga ndarjet buxhetore varen nga Qeveria. COVID-19 ka ushtruar shumë trysni plotësuese mbi buxhetet lokale, ndërsa shumë vija buxhetore janë tkurrur. Për të siguruar që komunat ushtrojnë përgjegjësitë e tyre, buxhetet dhe protokollet administrative do të duhet të ndryshohen për të mundësuar përfshirjen adekuate të QM-ve. Në disa komuna ka kufizime në numrin e kontratave të personelit që u lejohet të përgatisin. Stafit të QM-së i ofrohen kontrata shërbimi që duhet të përtërihen çdo gjashtë muaj, gjë që në vetvete cenon qëndrueshmërinë e parashikuar.

---

72 PLV i komunës së Ferizajt 2017-2021; PLV i komunës së Graçanicës 2018-2022; PLV i komunës së Lipjanit 2018-2022; PLV i komunës së Prizrenit 2019-2023.


73 PLV i komunës së Ferizajt 2017-2021, fq. 25-26.

74 Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët (SHFMU) “Haziz Tolaj”, SHFMU “Mustafa Bakiu”, SHFMU “Ibrahim Fehmiu”, SHFMU “Abdyl Frasheri” dhe SHFMU “Lekë Dukagjini”.

75 KEEN, “Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunat e Kosovës: Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë komuna të Kosovës”. Nëntor 2019, f. 20, gjendet tek: [http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Gjendja-e-komuniteteve-ne-komunat-e-Kosoves\\_ENG.pdf](http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Gjendja-e-komuniteteve-ne-komunat-e-Kosoves_ENG.pdf)

76 Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim – KEEN, “Situata e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunat e Kosovës: Raport monitorimi për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë komunat e Kosovës”, nëntor 2019, fq.82; 95.

77 KOSINT 2020, “Ndikimi i qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas në arsim”, Nëntor 2018, f. 30.



Në buxhetin e Kosovës 2020, 500 mijë euro<sup>78</sup> janë ndarë për funksionimin e QM-ve. Megjithatë, këto para u shënuan në linjë të gabuar buxhetore dhe nuk u shpërndanë asnjëherë tek QM-të gjatë vitit 2020.<sup>79</sup>

Gjatë vitit 2021, shifra prej 400,000 € u përmend si e destinuar për financimin e QM-ve në disa raste<sup>80</sup>, por nuk ndodhi kurrë.

Një koalicion i OJQ-ve që menaxhojnë QM-të u bënë bashkë për të avokuar me Ministrinë për të ndarë financimin e duhur për QM-të në buxhetin e vitit 2021.<sup>81</sup>

Në shtator 2021, MASHTI hapi thirrjen e parë për subvencionimin e QM-ve përmes OJQ-ve menaxhuese. Fillimisht në thirrje thuhej se 200,000 € do të ishin në dispozicion për OJQ-të që menaxhojnë QM-të. Megjithatë, pas shpalljes së kandidatëve të suksesshëm vetëm 97,000 € janë disbursuar.<sup>82</sup> Në maj 2022, u shpall një thirrje e dytë, duke u zotuar sërish 200,000 € për QM-të e regjistruara në MASHTI. Në korrik 2022, pesë OJQ-ve që menaxhonin 14 QM iu nda shuma totale prej 200,000€.<sup>83</sup>

Mos-disbursimi dhe zvogëlimi me 60 për qind i fondeve janë shumë shqetësuese për OJQ-të, por edhe donatorët. Shpallja e thirrjeve për financim nga qeveria është e mirëseardhur. Megjithatë, niveli i financimit në dispozicion nënkupton se vetëm një numër i vogël i QM-ve do të përfitojnë. MASHTI dhe DKA-të duhet të ndajnë buxhete të mjaftueshme për t'i mundësuar QM-ve të funksionojnë në mënyrë adekuate për numrin e fëmijëve të pranishëm. Sipas llogaritjeve të KOSINT-it prej 27 € në muaj për fëmijë, financimi i qeverisë për vitin 2022 vlerësohet të arrijë vetëm 20 për qind të asaj që kërkohet për 3,000 fëmijë në 47 QM-të aktualisht aktive.<sup>84</sup>

Numri i QM-ve aktive që nga prilli 2022 nuk është tregues i nevojës së përgjithshme, mbylljet e fundit i kanë lënë komunitetet të pashërbyera dhe ka thirrje të rregullta nga OJQ-të për të krijuar QM të reja. Një vlerësim i nevojave aktuale, hulumtimi i zonave me

---

78 Udhëzues praktik për zbatimin e Udhëzimit Administrativ 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e Qendrave Mësimore, f. 4.

79 Sipas drejtorit të Balkan Sunflowers Kosova, Muhamet Arifi, 500 mijë euro të ndara janë shënuar në linjën buxhetore për investime kapitale dhe mund të përdoren vetëm për këtë qëllim.


80 Zëvendëskryeminstrija Emilija Rexhepi njoftoi në Facebook se 400,000 euro do të ishin në dispozicion për QM-të në vitin 2022. Vegëza gjendet këtu, [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=1647722918946111&id=100011252565132](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1647722918946111&id=100011252565132)

81 Intervistë me Menaxher Arsimor, VoRAE, 1 prill 2021.

82 97,000 € iu dhanë vetëm tri organizatave joqeveritare aplikuese të suksesshme, të cilat drejtonin 22 qendra mësimore, shihni më shumë këtu: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/10/vendim-per-mbeshtetje-financiare-te-projk-te-ojq-ve-per-ojq-t-fituese.pdf>

83 Vendimi MASHTI 3 – 1483, publikuar më 12 korrik 2022 informon se Bethany Christian Services, që menaxhon një (1) QM i janë ndarë 22,000€, Caritas Kosova që menaxhon një (1) QM i janë ndarë 22,000€, Romani Iniciativa HAK, menaxhuese e dy (2) QM-ve iu ndanë 42,000 €, Terre Des Hommes që menaxhon nëntë (9) QM iu ndanë 92,000 € dhe Vizioni 02 që menaxhon një (1) QM iu ndanë 22,000 €, Vendimi në fjalë gjendet këtu, <https://masht.rks-gov.net/ojq-te-fituese-sipas-thirrjes-publike-per-ofrimin-e-mbeshtetjes-financiare-per-financimin-e-projekteve-te-ojq-ve-qe-drejtojne-qendra-mesimore-per-mbeshtetjen-e-nxenesve-rom-ashkalinj-dhe-egjiptian/>

84 Shifra e bazuar në 27 € në muaj për fëmijë për 3,000 fëmijë për një vit, nga llogaritjet e bëra në KOSINT 2020, "Ndikimi i Qendrave Mësimore në Përfshirjen e Fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Arsim", 2018, f. 7 dhe 29.



numër të lartë të fëmijëve jo-shumicë dhe numra të mëdhenj të braktisjeve të shkollave do të mund të kontribuonte ndjeshëm në përmirësimin e ndarjeve buxhetore për QM-të. Është e rëndësishme të theksohet se fondet e ndara deri më sot, pasi që mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të kostove aktuale të QM-ve, nuk kanë sjellë institucionalizimin e QM-ve sipas linjave të parashikuara fillimisht. Megjithatë, këto fonde janë të mirëseardhura si masë afatshkurtër kalimtare në pritje të ndarjes të fondeve më të konsiderueshme, që do të kanalizohen kryesisht përmes DKA-ve.

Financimi i duhur i QM-ve nuk do të jetë i mundur derisa të përcaktohet se çfarë përbën fjala 'i duhur'. Pa përcaktuar qartë se si duhet të llogariten kostot e QM-ve, UA-së 19/2018 i mungon elementi i rëndësishëm lehtësues për institucionalizim kuptimplotë.


## IV. Sfidat aktuale

Zbatimi i ngadaltë i UA-së 18/2019 ka vënë në pah çështjet e vazhdueshme të theksuara nga OJQ-të menaxhuese, si dhe sfida të reja. Pasiguria financiare vazhdon të jetë pengesa kryesore për QM-të, kryesisht si pasojë e vonesave të vazhdueshme në çuarjen përpara të zbatimit të plotë të UA 19/2018. Siç është theksuar tashmë, funksionimi i QM-ve është ende i varur nga mbështetja e donatorëve; megjithatë, kjo varësi nga përkrahja e donatorëve nuk paraqet zgjidhje të qëndrueshme në afat të gjatë. Për më tepër, interesimi i donatorëve ka rënë. Donatorët aktualisht janë duke operuar në korniza të periudhës tranzitore drejt zbatimit të plotë të UA 19/2018, ashtu që japin vetëm kontribute afatshkurtra ose afatmesme. Hartimi i UA 19/2018 dhe Udhëzuesit Praktik u financua nga vetë donatorët, duke shprehur mbështetjen e donatorëve për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme ku përfshihen institucionet që marrin përgjegjësinë për QM-të. Për t'i financuar QM-të të cilat ato menaxhojnë, disa OJQ-ve kohët e fundit u është dashur të kërkojnë fonde nga donatorë të rinj, që nuk ishin të angazhuar në zhvillimin e infrastrukturës ligjore apo të politikave.<sup>85</sup>

Kërkohen ndryshime në nivel qeveritar dhe komunal për të akomoduar linjën e re buxhetore dhe për të krijuar kode buxhetore të personelit brenda buxhetit komunal. Kjo gjithashtu do të kërkojë ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal për planifikimin e buxhetit. Disa komuna ku OJQ-të menaxhuese kanë organizuar tryeza të rrumbullakëta janë të njohura me UA 19/2018, por të tjerat me pak ose aspak OJQ aktive në komunën e tyre do të kenë nevojë për trajnime mbi rolet e reja që pritet t'i marrin dhe për krijimin e QM-ve të reja. Mosmarrëveshjet për procedurat e rekrutimit dhe planprograme janë

---

<sup>85</sup> Për shembull, Drejtori i Balkan Sunflowers shpjegoi se Rrjeti i Qendrave Mësimore, i përbërë nga pesë QM në katër komuna, është dashur të kërkojë fonde nga donatorë të rinj ndërkombëtarë për të mbështetur QM-të.



raportuar nga OJQ-të që menaxhojnë QM-të, ku komuna ka keqkuptuar dispozitat kalimtare që kanë të bëjnë me QM-të që funksionojnë para hyrjes në fuqi të UA-së.

Komunat do të duhet të zgjidhin edhe problemin e dhënies së kontratave afatshkurtra të punësimit të personelit të QM-së. Punonjësit e QM-së duhet të trajtohet si punonjës publikë dhe t'i gëzojnë përfitimet përkatëse. Skepticizmi për angazhimin e përgjithshëm të MASHTI-t për institucionalizimin e QM-ve është rishfaqur në disa qarqe për shkak të vonesave të zgjata, mospagesës së kontributit për 2020, tkurrjes së ndarjeve buxhetore të vitit 2021 dhe financimit të ulët më 2022. OJQ-të vënë në pikëpyetje angazhimin e Ministrisë, pasi vazhdojnë të kenë dyshime për qëndrueshmërinë afatgjate të QM-ve që ato menaxhojnë. Kjo përfshin edhe realizimin e obligimeve ministrore në lidhje me zhvillimin e programeve të trajnimit dhe vlerësimeve të parapara në UA 19/2018.

## V. Rruga Përpara


Aktualisht, zbatimi i UA 19/2018 është në ngërç, ku duhet gjetur dhe realizuar shpejt një zgjidhje e qëndrueshme. MASHTI ka mundësi që të institucionalizojë logjikën e QM-ve për të ofruar arsim më të barabartë për fëmijët nga komunitetet e marginalizuara.

Për ta mbajtur të gjallë këtë proces dhe për të shënuar progres në të, MASHTI mund ta shfrytëzojë mbështetjen e mëparshme dhe brengën aktuale të bashkësisë ndërkombëtare për të ardhmen e QM-ve, si dhe të zgjedhë një partner për të hartuar një udhërrëfyes me afate kohore për tejkalimin e çështjeve mbizotëruese. Aty do të trajtoheshin të gjitha opsionet rreth financimit të qëndrueshëm nga qeveria, për komunat dhe për QM-të, si dhe të hulumtonte mundësitë për financim plotësues nga qeveria. Udhërrëfyesi duhet t'i hulumtojë edhe opsionet e mundshme rreth financimit të drejtpërdrejtë nga qeveria dhe sfidat e buxhetimit komunal. Kjo do të kërkonte llogaritje specifike të kostos aktuale të operimit dhe mbajtjes së QM-ve në baza mujore dhe vjetore, si dhe kush do të duhej t'i bartte ato kosto. Udhërrëfyesi duhet të përfshijë edhe të gjitha detyrimet e tjera të MASHTI-t, duke përfshirë monitorimin, mbledhjen e të dhënave, raportimin, vlerësimin e standardizuar, buxhetimin vjetor dhe zhvillimin e programeve të trajnimit me Universitetin e Prishtinës (UP).

Para se komunat të marrin përsipër pagesën e stafit të QM-ve, duhet të krijohet një kod specifik për këtë qëllim nga Ministria e Financave. Me këtë kod të përfshirë në tabelat e tyre të stafit komunal, komunat mund t'u ofrojnë mësimdhënësve kontrata të rregullta pune dhe t'i integrojnë plotësisht në drejtoritë përkatëse të arsimit.

Autoritetet komunale duhet të kenë qasje proaktive për të ofruar mbikëqyrje dhe mbështetje për QM-të. UA 19/2018 thekson qartë se ato kanë rol të rëndësishëm në





operacionet e QM-ve dhe kjo nuk duhet të varet nga vullneti politik. DKA-të duhet të përfshijnë QM-të në buxhetet e tyre vjetore duke ndarë linjat buxhetore dhe kodet për stafin. Anëtarët e Kuvendit Komunal nga Komiteti për Politika dhe Financa mund të hartojnë kërkesë zyrtare për drejtorin, pas së cilës konsultimi publik me OJQ-të përkatëse dhe palët e interesit do të ushqente edhe draftin e kërkesës zyrtare për të shtuar linjat dhe kodet e nevojshme buxhetore në drejtori. Pas miratimit, drejtorja, në konsultim me Kryetarin e Komunës, duhet të bëjë ndarjet dhe ndryshimet e nevojshme buxhetore. Përzgjedhja e stafit të ri duhet gjithashtu të bëhet në përputhje me dispozitat e përshkruara në UA.

OJQ-të duhet të bëhen bashkë në një front për të punuar në çështjet që i ballafaqojnë me përmbushjen e standardeve të UA 19/2018, si dhe të gjejnë një gjuhë të përbashkët për të adresuar të gjitha shqetësimet e tyre tek MASHTI. Kjo mund të marrë formën e një grupimi ombrellë për interesat e QM-ve në lidhje me institucionalizimin e tyre, duke përfshirë edhe QM-të që do të merren përsipër nga komunat edhe OJQ-të menaxhuese. Faktor i rëndësishëm është që pikëpamjet e tyre të jenë të përfaqësuara dhe çështjet urgjente të paraqiten në mënyrë koherente dhe konsistente. Qasjet e fragmentuara nga OJQ-të individuale mund ta vonojnë më tej procesin.

Paralelisht, palët e interesit lidhur me QM-të duhet të rishikojnë UA 19/2018 për të gjitha mangësitë, sidomos në lidhje me shumën e financimit nga secili burim, si dhe të specifikojnë se si duhet të llogaritet kjo shumë. Projektionet duhet të marrin parasysh numrin e fëmijëve që ndjekin, ose që mund të ndjekin mësimet e caktuara në një QM. Afatet kohore po ashtu duhen të rregullohen, pasi afati aktual në UA 18/2019 parasheh që QM-të që ende nuk janë regjistruar do të jenë jashtë ligjit deri në fund të vitit 2023.

Donatorët mund të luajnë ende rol në formimin e programeve më të mira brenda kapaciteteve të QM-ve. Ndërsa MASHTI dhe komunat marrin përsipër shpenzimet kryesore dhe të përditshme të funksionimit, donatorët kanë ende fleksibilitet për të siguruar financim për projekte të tjera. Këto projekte mund t'i pasurojnë aktivitetet e QM-ve duke ofruar programe plotësuese edukative e aftësuese për fëmijët dhe stafin e QM-ve, duke përmirësuar efektivitetin e QM-ve, pajisjet, hapësirat apo edhe duke zgjeruar programet për më shumë përfitues, duke përfshirë prindërit, të rinjtë dhe të kthyerit, me fokus të veçantë tek gratë.

## VI. Konstatime

Vonesat dhe pasiguria rreth zbatimit të UA 19/2018 kanë përballur QM-të me kushte të vështira të përshkruara në këtë raport, duke krijuar sfida serioze për ata që menaxhojnë QM-të. Ato kanë ngecur midis obligimeve të parapara me kornizën ligjore dhe mungesës së udhëzimeve procedurale. Pritjet e QM-ve dhe donatorëve në lidhje me atë që mund të arrihet përmes kornizës së re ligjore nuk janë përmbushur. Sigurisht që vonesat nga MASHTI-t për të dhënë me kohë udhëzime të nevojshme për regjistrimin dhe ndarjen e fondeve si nga buxheti i qeverisë ashtu edhe ai lokal kanë ndikuar në këtë situatë.<sup>86</sup> Pa dyshim, pandemia globale dhe kufizimet shoqëruese i kanë përkeqësuar këto vonesa, pasi burimet dhe fondet duhej të riorientoheshin për të përballuar sfidat tjera.

Është e qartë se ka veprime që MASHTI mund dhe duhet t'i ndërmarrë për të çuar përpara zbatimin e të gjitha aspekteve të UA 19/2018. **Kjo do t'i mundësonte të gjitha QM-ve të përtërijnë/përforcojnë funksionimin e tyre të plotë për vitin akademik 2023/2024,** si dhe të vazhdojnë t'i kryejnë punët e rëndësishme me dhe për fëmijët. Si MASHTI ashtu edhe komunat duhet të punojnë së bashku dhe të marrin përgjegjësi për rolet e tyre të reja në zbatimin e UA-së, në bashkëpunim të ngushtë me ato OJQ që kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme.


## VII. Rekomandime

### Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

- Të monitorohet zbatimi dhe efektshmëria e UA-së 19/2018 përmes Zyrës Ligjore të Ministrisë.
- Të rriten dhe sigurohen ndarjet buxhetore vjetore për kostot bazë të QM-ve bazuar në numrin e fëmijëve që i ndjekin ato.
- Të hartohen udhëzime, mostra e afate kohore të qarta për QM-të e regjistruara për raportimin e tyre tek MASHTI për aktivitetet e tyre.
- Të sigurohet që komunat të jenë të informuara mirëfilli për kompetencat dhe obligimet e tyre.

---

<sup>86</sup> Udhëzues për zbatimin e Udhëzimit Administrativ 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e Qendrave Mësimore, f. 4.

- 
- Të mbështeten komunat në identifikimin e hapësirës për krijimin e QM-ve të reja dhe të udhëzohet procesi i krijimit të QM-ve të reja.
  - Të ndërmerren aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve me DKA-të dhe OJQ-të menaxhuese, për planifikim efektiv të buxhetit, si dhe në procesin e vlerësimit vjetor dhe raportimit me Inspektoratin e Arsimit.
  - Të fillohet hartimi i programeve specifike të trajnimit për stafin e QM-ve, në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës, sipas UA 19/2018.<sup>87</sup>
  - Të trajtohen mangësitë e UA 19/2018 me të gjitha palët e interesuara në lidhje me buxhetimin dhe procedurat kalimtare.

## **Për Ministrinë e Financave**

- Të krijohen kode specifike buxhetore për të akomoduar personelin e QM-ve.

## **Për Drejtoritë Komunale Arsimore**


- Të ndryshohen buxhetet komunale për t'i mundësuar QM-ve të gëzojnë mbështetje të plotë brenda buxhetit vjetor.
- Të sigurohet regjistrimi i informatave të përditësuara në të gjitha QM-të aktive në komunë.
- Të bashkëpunohet me OJQ-të që menaxhojnë QM-të në komuna dhe të sigurohet hartimi, nënshkrimi dhe përtëritja e Memorandumeve të Mirëkuptimit ndërmjet DKA-së dhe QM-ve.
- Të trajnohet stafi për rolet dhe obligimet e përcaktuara në UA 19/2018.
- Të planifikohet mbështetja vjetore për QM-të në buxhetin komunal.

## **Për donatorët**

- Të bashkërendohen përpjekjet me donatorë të tjerë afatgjatë për t'i dhënë prioritet çështjes së QM-ve me MASHTI-n.
- Të vazhdohet financimi i programeve që avancojnë përjetimin edukativ në QM, të tilla si programet verore dhe dimërore, vizitat shkëmbyese e studimore, sigurimi i ushqimit dhe aktivitete të tjera jo-thelbësore.

---

87 UA 19/2018, neni 8, paragrafi 5.4.

- 
- Të organizohen takime me përfaqësues komunalë për të rritur vetëdijesimin për rëndësinë e QM-ve.
  - Të ofrohet ndihmë teknike ose financiare për komunat që mbështesin QM-të.

## **Për OJQ-të që menaxhojnë QM-të**

- Të vazhdohet avokimi për rëndësinë e QM-ve për arsimim të barabartë dhe të sigurohet që kjo të mbetet në agjendën qeveritare.
- Të bashkohen forcat me OJQ-të e tjera menaxhuese dhe palët e interesit për të kanalizuar në mënyrë adekuate shqetësimet dhe sfidat aktuale ndaj qeverisë.
- Të ketë monitorim e raportim për zbatimin e vazhdueshëm të UA 19/2018.
- Të regjistrohen QM-të në përputhje me UA 19/2018.
- Të bashkëpunohet dhe të ndahen praktikat e mira me DKA-të për mënyrën se si funksionon menaxhimi i QM-ve.
- Të përkrahen komunat në identifikimin e shkollave me norma të ulëta regjistrimi, vijimi apo braktisje të lartë për të krijuar QM të reja në përkrahje të nxënësve për të qëndruar në shkollë.

**Tabela 1. Informata për OJQ-të që menaxhojnë QM-të dhe komunat më 2021 dhe 2022**

#	Organizata Joqeveritare	QM-të -2021	QM-të - 2022
1.	<i>Terre des Hommes (TdH)</i>	20	8
2.	<i>EDU Task dhe ADEC</i>	20	1
3.	<i>Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE)</i>	19	14
4.	<i>Nevo Koncepti</i>	10	6
5.	<i>Syri i Vizionit (SiV)</i>	2	2
6.	<i>Balkan Sunflowers of Kosovo (BSFK)</i>	5	5
7.	<i>The Ideas Partnership (TIP)</i>	2	2
8.	<i>CARITAS Kosovë</i>	2	2
9.	<i>Bethany Christian Services (BCS)</i>	6	1
10.	<i>Këshilli Danez për Refugjatë/Qendra Sociale për Romë e Ashkali</i>	1	1
11	<i>Romano Anglunipe</i>	1	1
12	<i>Romani Inciyativa HAK</i>	1	1
13	<i>Vizioni 02</i>	3	3
<b>Gjithsej Qendra Mësimore</b>		<b>92</b>	<b>47</b>

Të dhëna të mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren, në prill 2022.

QM-të që funksionojnë që nga prilli 2022	QM-të e mbyllura që nga prilli 2022	Nr. i nxënësve aktivë	Regjistruar në MASHTI	QM që kanë nënshkruar MM me komunën
<b>Prizren</b>				
5	9	250	1	4
<b>Suharekë</b>				
4	0	179	2	4
<b>Rahovec</b>				
1	2	22	1	1
<b>Prizren gjithsej</b>				
<b>10</b>	<b>11</b>	<b>451</b>	<b>4</b>	<b>9</b>
<b>Gjilan</b>				
1	3*	35	0*	1
<b>Kamenicë</b>				
0	2			
<b>Novobërdë</b>				
1	0	17	0*	1
<b>Ferizaj</b>				
4	0	331	4	4
<b>Gjithsej Gjilan</b>				
<b>6</b>	<b>5</b>	<b>383</b>	<b>4</b>	<b>6</b>
<b>Mitrovicë Jug</b>				
1	2	120	0	1
<b>Vushtrri</b>				
3	0	123	0*	3
<b>Podujevë</b>				
2	3	83	0	2
<b>Gjithsej Mitrovicë</b>				
<b>6</b>	<b>5</b>	<b>326</b>	<b>0</b>	<b>6</b>
<b>Pejë</b>				
<b>Gjakovë</b>				
3	8	299	1	0
<b>Pejë</b>				
2	6	44	0*	2
<b>Istog</b>				
5	3	88	3	2
<b>Klinë</b>				
0	5	0	0	0
<b>Gjithsej Pejë</b>				
<b>10</b>	<b>22</b>	<b>431</b>	<b>4</b>	<b>4</b>



<b>Prishtinë</b>				
0	7	0	0	0
<b>Graçanicë</b>				
2	0	120	2	2
<b>Fushë Kosovë /</b>				
2	0	570	1	1
<b>Shtime</b>				
3	2	151	3	2
<b>Obiliq</b>				
3	0	170	3	2
<b>Lipjan</b>				
5	1	386	4	5
<b>Gjithsej Prishtinë</b>				
<b>15</b>	<b>10</b>	<b>1,394</b>	<b>13</b>	<b>12</b>
<b>GJITHSEJ KOSOVA</b>				
<b>47</b>	<b>53</b>	<b>2,990</b>	<b>25</b>	<b>37</b>





